



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005, nenet 14 dhe 15 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2023, miratoi këtë,

### VENDIM PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2024

#### Neni 1

##### Normat Tatimore

1. Caktohen normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave në territorin e Komunës së Podujevës, me përjashtim të kategorisë-pronë publike dhe përjshimeve tjera sipas legjislacionit përkatës, si vijon:

1.1. Për njësitë bujqësore të parcelave.....	0.10 %
1.2. Për njësitë bujqësore të objekteve.....	0.10 %
1.3. Për njësitë pyjore të parcelave.....	0.10 %
1.4. Për njësitë rezidenciale të parcelave.....	0.10 %
1.5. Për njësitë rezidenciale të objekteve.....	0.15 %
1.6. Për njësitë komerciale të parcelave.....	0.15 %
1.7. Për njësitë komerciale të objekteve.....	0.15 %
1.8. Për njësitë industriale të parcelave.....	0.15 %
1.9. Për njësitë industriale të objekteve.....	0.15 %

2. Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, (neni 9 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9), dhe Ligjit nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (neni 39/A).

#### Neni 2

##### Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë.

#### Neni 3

##### Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021, dhe i njëjti zbatohet nga data 01 janar 2024.

Nr.Prot. 01-431/03-0071624/23  
Podujevë, datë; 27 shtator 2023

